



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 62 dt.21/04/2000

**PËR VENDOSJEN NË NJË NGA MJEDISET E QYTETIT TË TIRANËS
VEPRËN SKULPTUR PARKU “ TIRANA QYTETI I ZEMRAVE TË
HAPURA”**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, pasi u njoh me propozimin për të vendosur në një nga mjediset e hapura të qytetit simbolin e cilësimit të Tiranës si i pari qytet i zemrave të hapura, për mikpritjen e madhe që tregoi gjatë ditëve të ardhjes së refugjatëve kosovar, mbështetur në ligjin 7572 dt 10.06.1992 “ për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal” neni 14, pika 15 dhe neni 7,10,16

V E N D O S I

1. Të miratojë për tu vendosur në një nga mjediset e Tiranës veprën skulptur parku “ TIRANA QYTETI I ZEMRAVE TË HAPURA”
2. Vepra është dhurat e fondacionit me të njëjtin emër në ZVICER.
3. Ngarkohet Drejtoria e Urbanistikës të përcaktojë vendin për këtë vepër.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Dr. ORHAN SAKIQI